

VENDIM
Nr. 594, datë 22.7.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS DHE PROCEDURAT E PAGESËS SË KOSTOS
SË SHENJIMIT DHE GJURMIMIT TË BIMËS SË *CANNABIS*-IT DHE TË
NËNPRODUKTEVE DHE PRODUKTEVE TË SAJ PËR QËLLIME MJEKËSORE
DHE INDUSTRIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 34, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, me propozimin e ministrit të Financave, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifa e shenjimit dhe gjurmimit përfshin:
 - a) tarifën vjetore për përdorimin e sistemit të gjurmimit;
 - b) tarifën për shenjimin dhe gjurmimin për çdo bimë të *cannabis*-it;
 - c) tarifën për shenjimin dhe gjurmimin për çdo pako.
2. Për zbatimin e sistemit të gjurmimit të farës, të bimës mëmë, të klonit, të fidanit, të bimës, të mbetjeve, të nënproduktit apo të produktit të *cannabis*-it, si dhe paketimet e tyre në forma të ndryshme (paketa, kontejnerë, thasë etj.), të cilët shenjohen me etiketë, aplikohen këto tarifa:
 - a) Tarifa vjetore për përdorimin e sistemit të shenjimit dhe të gjurmimit është 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) dollarë amerikanë për çdo subjekt të licencuar e të lejuar, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe taksat e tjera të aplikueshme;
 - b) Tarifa për shenjimin dhe gjurmimin për çdo klon, fidan, bimë mëmë dhe bimë të rritur *cannabis*-i është 0.53 (zero presje pesëdhjetë e tre) dollarë amerikanë, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe taksat e tjera të aplikueshme, sipas kuadrit ligjor në fuqi;
 - c) Tarifa për shenjimin dhe gjurmimin për çdo pako, material të ambalazhuar apo kontejnerë është 0.33 (zero presje tridhjetë e tre) dollarë amerikanë, pa përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe taksat e tjera të aplikueshme.
3. Shoqëria “*ALBTrace Co*” sh.a. lëshon faturë për tarifën vjetore të përdorimit të sistemit të gjurmimit për çdo subjekt të licencuar ose të lejuar, përpara aksesit të parë dhe për çdo vit kalendarik pasardhës, e cila përmban:
 - a) shumën në dollarë amerikanë dhe shumën ekuivalente të konvertuar në lekë, sipas kursit të ditës së lëshimit të faturës, publikuar nga Banka e Shqipërisë, në datën e lëshimit të faturës;
 - b) shumën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) të llogaritur në dollarë amerikanë dhe shumën ekuivalente në lekë, sipas kursit të ditës së lëshimit të faturës;
 - c) llogarinë bankare në Shqipëri të shoqërisë “*ALBTrace Co*” sh.a. në të cilën kryhet pagesa.
4. Për çdo porosi në sistemin e gjurmimit në rastet e shenjimit të klonëve, fidanëve, të bimës mëmë dhe të bimëve të rritura, subjekti i licencuar ose i lejuar deklaron sasinë përkatëse. Në bazë të deklarimit, shoqëria “*ALBTrace Co*” sh.a. lëshon faturën përkatëse, e cila përmban:
 - a) sasinë e deklaruar;
 - b) shumën në dollarë amerikanë dhe shumën ekuivalente të konvertuar në lekë, sipas kursit të ditës së lëshimit të faturës, publikuar nga Banka e Shqipërisë;
 - c) shumën e tatimit mbi vlerën e shtuar të llogaritur në dollarë amerikanë dhe shumën ekuivalente në lekë, sipas kursit të ditës së lëshimit të faturës, publikuar nga Banka e Shqipërisë;
 - ç) llogarinë bankare në Shqipëri të shoqërisë “*ALBTrace Co*” sh.a., ku kryhet pagesa.
5. Për çdo porosi në sistemin e gjurmimit në rastet e shenjimit të pakove, të materialeve të ambalazuara dhe të kontejnerëve, subjekti i licencuar ose i lejuar deklaron numrin e pakove

për shenjim. Në bazë të deklarimit, shoqëria “ALBTrace Co” sh.a. lëshon faturën përkatëse, e cila përmban:

- a) numrin e pakove, të materialeve të ambalazuara ose të kontejnerëve;
- b) shumën në dollarë amerikanë dhe shumën ekuivalente të konvertuar në lekë, sipas kursit të ditës së lëshimit të faturës, publikuar nga Banka e Shqipërisë;
- c) shumën e tatimit mbi vlerën e shtuar të llogaritur në dollarë amerikanë dhe shumën ekuivalente në lekë, sipas kursit të ditës së lëshimit të faturës, publikuar nga Banka e Shqipërisë;
- ç) llogarinë bankare në Shqipëri të shoqërisë “ALBTrace Co” sh.a., ku kryhet pagesa.

6. Çdo subjekt i licencuar ose i lejuar është i detyruar të kryejë pagesën e plotë të çdo fature fiskale elektronike të lëshuar nga shoqëria “ALBTrace Co” sh.a., vetëm në dollarë amerikanë, brenda 8 (tetë) ditëve nga data e dërgimit të saj në rrugë elektronike, në llogarinë bankare të përcaktuar në faturë.

7. Asnjë etiketë ose kod unik i shenjimit nuk aktivizohet për subjektin e licencuar ose të lejuar, në rast se nuk është kryer pagesa e plotë e shumës së përcaktuar në faturën e lëshuar nga shoqëria “ALBTrace Co” sh.a.

8. Porosia e kryer nga subjektet e licencuara ose të lejuara i përket vetëm subjektit porositor dhe është e ndaluar shitja, transferimi, tjetërsimi, dhënia në përdorim apo vënia në dispozicion e saj, në çfarëdo forme për subjekte të tjera.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it, shoqëria “ALBTrace Co” sh.a., si dhe subjektet e licencuara dhe të lejuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Albana Koçi